

Ref: 02/STIKK/2019

## **FTESË PËR OFERTIM: AUDITIMI I PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITET 2019-2021**

**Datat e publikimit:** 22 janar 2019

**Data e mbylljes:** 4 shkurt 2019, ora 16:00

**Data e njoftimit:** Më së largu me 28 shkurt 2019  
(Pas mbajtjes së Mbledhjes së Kuvendit që është e paraparë në shkurt 2019)

**Objekti i kontratës:** Marrëveshje e shërbimit

**Autoriteti kontraktues:** Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës (STIKK)

### 1. Hyrje

Si një katalizator në industrinë dinamike të teknologjisë, STIKK përshpejton rritjen dhe progresin në ekonomi. STIKK ofron një platformë që bashkon liderët e teknologjisë për t'u lidhur dhe bashkëpunuar me njëri-tjetrin dhe mbështet me entuziazëm anëtarët që shtynjë përpara kufijtë e teknologjisë.

Që nga themelimi në 2008, STIKK arriti suksese të shumta dhe u bë një nga shtytësit kryesorë të industrisë së TIK-ut dhe komunitetit të TIK-ut në Kosovë. Gjatë përpjekjeve drejt zhvillimit të vazhdueshëm të industrisë së TIK, STIKK ka realizuar projekte të shumta që kanë për qëllim promovimin e sektorit të TIK të Kosovës, përmirësimin e kornizës ligjore, implementimin e hulumtimeve dhe analizave specifike të industrisë si dhe të ndihmojë në zhvillimin e profesional të aktorëve të sektorit.

STIKK fton kompanitë audituese që të ofertojnë për të kryer shërbimet e auditimit sipas IFRS dhe rregullave të ATK-së për vitet financiare prej **01.01.2019** deri me **31.12.2021**.

### 2. Kushtet dhe rregullat e kuotimit

Ofertuesit e interesuar, së bashku me ofertën duhet të dorëzojnë edhe dokumentacionin shtesë si në vijim:

- Certifikata e regjistrimit të biznesit;
- Certifikata e regjistrimit fiskal;
- Licenca nga organet kompetente për kryerjen e punëve;
- Referenca mbi kryerjen e punëve të ngjashme;
- CV-të e auditorëve që do të bëjnë auditimin.

Oferta duhet të përmbajë:

- Planin gjeneral të auditimit;
- Afatin kohor të propozuar;
- Kërkesa për dokumentacionet që duhen të përgatiten paraprakisht nga ana e OJQ-së;
- Tarifat për auditorë;
- Shumën totale të auditimit (Në rast se çmimet dorëzohen pa e specifikuar TVSH-në, Shoqata do të konsiderojë se çmimi përfshinë TVSH-në).

### 3. Udhëzime për dorëzim të ofertave

- Ofruesit e Shërbimit duhet të dërgojnë ofertat e tyre, së bashku me të gjitha dokumentet e nevojshme, deri më **4 shkurt 2019**, ora **16:00**;
- Oferta duhet të dorëzohet përmes zarfit të mbyllur në Zyret e STIKK (Rr. Rexhep Mala 28A, 10000, Prishtinë) duke shënuar numrin e ftesës për ofertim: **Ref: 02/STIKK/2019**;
- Ofertat do të vlerësohen në bazë të kriterëve të mëposhtme:

### 4. Kriteret e vlerësimit

Kriteri	%
<b>1. Kriteret Kualitative</b>	
1.1. Historiku dhe përvoja e Kompanisë/Personit Fizik	30
1.2. Referenca me detaje të kontaktit ( <i>minimum 3 referenca</i> )	10
<b>2. Kriteret Financiare</b>	
2.1. Ofertë ekonomikisht më e favorshme	60
<b>Totali:</b>	<b>100</b>

### 5. E drejta për ankesë

Çdo ofertues ka të drejt për ankesë, të cilën mund të dërgoni në [info@stikk.org](mailto:info@stikk.org) brenda 7 ditëve kalendarik nga momenti i pranimit të emailit me rezultate nga Zyra Ekzekutive e STIKK.

--

Për cdo pyetje, mund të dërgoni kërkesë me shkrim përmes email-it në këtë adresë: [info@stikk.org](mailto:info@stikk.org). Kërkesat pranohen deri më **3 shkurt 2019**.